

Tekst i konsoliduar jozyrtar ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.41/2011 dhe 20/2015)

Në bazë të nenit 158-s pika 1, neni 154 paragrafi 1 pika 3 dhe në lidhje me nenin 152 të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/2002, 84/2002, 98/2002, 33/2004, 88/2005, 79/2007, 08/2008, 88/2008, 56/2009 dhe 67/2010), Këshilli i Ekspertëve të Agjensisë për Mbikqyrje të Sigurimeve në mbledhjen e mbajtur në 10.03.2011 miratoi si në vijim

## **RREGULLORE**

### **Për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes të regjistrave të ndërmjetësuesve në sigurime dhe brokerëve të sigurimeve nga ana e shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit në sigurime dhe shoqërive për ndërmjetësim në sigurime**

#### **Dispozita të përgjithshme**

##### **Neni 1**

Me këtë rregullore parashkruhet forma, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes të regjistrave të:

1. ndërmjetësuesve në sigurime, shoqërive për ndërmjetësim në sigurime, shoqërive për brokerim në sigurime dhe banka **nga ana e shoqërive të sigurimeve dhe risigurimeve** (në tekstin si më poshtë: shoqëri sigurimi);
2. Brokerë për sigurime **nga ana e shoqërive të brokerimit në sigurime dhe**
3. ndërmjetësuesve në sigurime **nga ana e shoqërive për ndërmjetësim në sigurime.**

#### **Rregjistra të cilat i mbajnë shoqëritë e sigurimeve**

##### **Neni 2**

(1) Shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara të mbajnë rregjistër të:

1. ndërmjetësuesve në sigurime;
2. shoqërive për ndërmjetësim në sigurime;
3. shoqërive për brokerim në sigurime dhe
4. banka të cilat kanë leje për kryerjen e punëve për ndërmjetësim në sigurime

(2) Përveç dispozitave në paragrafin (1) të këtij neni, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara të mbajnë rregjistra dhe për të gjitha subjektet e tjera të cilët në bazë të përjashtimeve të parashikuara në nenin 133 paragrafi (2) dhe nenin 135 paragrafi (2) të Ligjit për Mbikqyrje të Sigurimeve, në emër dhe për llogari të shoqërive për sigurime kryejnë punë të lidhura me shitjen dhe ofrojnë polisa sigurimi.

(3) Rregjistrat sipas paragrafit (1) dhe (2) të këtij neni janë publikë dhe në formë elektronike publikohen në (web) faqën e shoqërisë të sigurimeve ;

Tekst i konsoliduar jozyrtar ("Gazeta zyrtare e RM" nr.41/2011 dhe 20/2015)

### **Rregjistra të cilat i mbajnë shoqëritë e brokerimit në sigurime**

#### **Neni 3**

(1) Shoqëritë e brokerimit në sigurime janë të obliguara të mbajnë rregjistra për brokerat për sigurime të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune në shoqërinë e brokerimit në sigurime.

(2) Rregjistri sipas paragrafit (1) të këtij neni është publik dhe në formë elektronike publikohet në (web) faqën e shoqërisë të brokerimit në sigurime.

### **Rregjistra të cilat i mbajnë shoqëritë për ndërmjetësim në sigurime**

#### **Neni 4**

(1) Shoqëritë për ndërmjetësim në sigurime janë të obliguara të mbajnë rregjistra të:

1. ndërmjetësuesve në sigurime të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune në shoqërinë për ndërmjetësim në sigurime;

2. ndërmjetësuesve në sigurime të cilët në baza të tjera juridike me shoqërinë për ndërmjetësim në sigurime kryejnë veprimtari për përfaqësim në sigurime;

(2) Rregjistri sipas paragrafit (1) të këtij neni është publik dhe i njëjti në formë elektronike publikohet në (web) faqën e shoqërisë për ndërmjetësim në sigurime;

### **Rregjistrimi i të dhënave në rregjistra të veçantë**

#### **Neni 5**

(1) Rregjistrimi i të dhënave në rregjistrin e veçantë sipas nenit 2 paragrafi (1), nenit 3 paragrafi (1) dhe nenit 4 paragrafi (1) të kësaj rregulloreje kryhet në bazë të:

1. vendimit (lejës, miratimit, licencës) lëshuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes të Sigurimeve;
2. lidhjes të kontratës për ndërmjetësim në sigurime, ose kontratës për kryerjen e punëve të brokerimit në sigurime me subjektin e duhur ose kontratë tjetër;
3. kërkesë e dorëzuar me dokumentacionin e duhur nga ana e subjektit për ndryshimin e të dhënave të cilat rregjistrohen në rregjistër;

(2) Rregjistrimi i të dhënave në rregjistrin e veçantë sipas nenit 2 paragrafi (2), të kësaj rregulloreje kryhet në bazë të:

1. kontratës të lidhur me subjektin i cili, në bazë të përjashtimeve të parashikuara në nenet 133 paragrafi (2) dhe 135 paragrafi (2) të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve, në emër dhe për llogari të shoqërive të sigurimeve kryen aktivitete të lidhura me shitjen dhe ofrimin e policave për sigurime;
2. kërkesës të dorëzuar me dokumentacionin e duhur nga ana e subjektit për ndryshimin e të dhënave të cilat rregjistrohen në rregjistër;

(3) Të gjitha ndryshimet e të dhënave të cilat janë futur në rregjistrin e veçantë rregjistrohen në mënyrë që në të dhënat të cilat ndryshohen shënohet dhe data e përfundimit të vlefshmërisë të tyre, data e fillimit dhe përmbajtja e të dhënave të reja.

(4) Rregjistrimi i të dhënave në rregjistrin e veçantë në përputhje me paragrafet (1) dhe (2) të këtij nenin kryhet brenda afatit 24 orë nga dita e bërjes së ndryshimit.

## **Përmbajtja e rregjistrave**

### **Neni 6**

Në rregjistrat sipas nenit 2 paragrafi (1) dhe (2), neni 3 paragrafi (1) dhe neni 4 paragrafi (1) të kësaj Rregulloreje rregjistrohen më e pakta të dhënat në vijim:

- Emërtimi i plotë i shoqërisë për ndërmjetësim në sigurime, shoqërisë të brokerimit në sigurime, banka ose subjekt tjetër dhe selia e tij/e saj.
- Emri dhe mbiemri i plotë i ndërmjetësuesit në sigurime, brokerit për sigurime;
- Numri i vendimit me të cilin Agjencia i ka dhënë lejen, miratimin ose licencën për kryerjen e aktiviteteve për ndërmjetësim në sigurime, kryerjen e aktiviteteve të brokerimit në sigurime, (datën e lëshimit të lejës/licencës dhe për cilat klasa të sigurimeve ) duke u referuar në NRS (numrin e rregullt të subjektit) lëshuar nga Agjencia;
- Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës në shoqëri/ndërmjetësues në sigurime i licencuar, broker për sigurime, ose person tjetër dhe eventualisht NRS ( numrin e rregullt të subjektit);
- Numrin e telefonit dhe numrin e telefaksit;
- Adresën e telefonit dhe adresën e faqes të internetit të shoqërisë për ndërmjetësime në sigurime, shoqërisë të brokerimit në sigurime, bankës, ose subjektit tjetër;
- Data e përfundimit të kryerjes të aktiviteteve për ndërmjetësime në sigurime, ose aktiviteteve në brokerimin e sigurimeve;

## **Dispozita përfundimtare**

### **Neni 8**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës të Maqedonisë”.

Nr.0101-1101/3

10.03.2011

**Kryetari i Këshillit të Ekspertëve**

**d.r Klime Popovski**